ALBKOS SAFETY SH.P.K.
NRB 811440908 | TVSH 330455958
Rr. e Pejës 26 ▪ 2000 Fushë Kosovë ▪ Republika e Kosovës
Tel./Fax: +303(38) 534 653, GSM: +383 (44) 504 605
Email: info@albkossafety.com
www.albkossafety.com

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit: KEK-21-8187-1-2-1

Sa i përket tenderit për: Furnizim me AKZ, instalimi dhe shqyrtimi i sistemeve aktuale për shuarjen e zjarrit

ANKESË

1. IDENTIFIKIMI I ANKUESIT*

ALBKOS SAFETY SH.P.K.
(shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. e Pejës, nr. 26
(Adresa)

Fushë Kosovë
(Vendi)

12000
(Kodi Postar)

044 504 605
(Numri i telefonit)

038 534 653
(Numri i faksit)

Emin Mirena
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@albkossafety.com
(adresa elektronike)

28.03.2022
(data e parashtrimit të ankesës)

(nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. TË DHËNAT MBI AKTIVITETIN E PROKURIMIT

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

01	Njoftim për kontratë	26.10.2021
	Dorëzimi i dosjes së tenderit	15.11.2021 / 12:00
	Kriter për dhënien e kontratës	Çmimin më i ultë
	Buxheti i planifikuar	60.000,00 EUR
02	Procesverbali i hapjes se tenderit	15.11.2021
03	Njoftimi mbi vendimin e AK	09.03.2022
04	Kërkesa për qasje ne dok. e OE fitues	09.03.2022
05	Aprovimi për qasje në dok. e OE fitues	11.03.2022
06	Kërkesë për rishqyrtim	14.03.2022
07	Vendimi mbi rishqyrtimin e kërkesës për rishqyrtim	17.02.2022

3. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **JO** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **JO** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **JO** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Të gjitha faktet janë trajtuar në piken 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet dhe janë bashkangjitur provat.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 – Qëllimi
Neni 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7 – Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
Neni 59 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 69 –
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 dhe 9.2. i dosjes se tenderit

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Bazuar në Ligjin për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës, Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 si dhe RRUOPP AK nuk ka vepruar ne përputhje me Ligjin dhe Rregulloren e përmendur më sipër, prandaj nuk pajtohemi me vendimin e AK, për faktet e cekura më poshtë:

Tenderi është publikuar më 15.11.2021

Kanë marrë pjesë katër OE, me çmimet si më poshtë:

Albkos Safety Sh.p.k.	57.945,67 EUR
Profesional Alarm Sh.p.k.	49.226,06 EUR

Provë 1: *Proceverbali i hapjes*
Dokumenti: *02 _Procesverbali i hapjes.pdf*

Pasi na është dhënë qasje në dosjen e OE të propozuar për tu shpërblyer me kontratë kemi konstatuar si vijon:

1. OE Profesional Alarm, në pozicionet ***3, 5, 10, 12 dhe 13*** ka ofertuar me produkte të prodhuesit Mobiak SA, Greqi dhe si dëshmi ka dorëzuar një katalog te emëruar si ***KATALOGU SISTEMET EKZISTUESE.pdf***.

   Katalogu për pozicionet në fjalë është shkarkuar nga interneti, nga një faqe e Arabisë Saudite http://www.inter.sa dhe një pjesë tjetër nga faqe greke http://www.afoimavroudi.gr/.

   Provë 2: *08 _Katalogu sistemet ekzistuese.pdf (dorëzuar nga OE Profesional Alaram_*

   Asnjëra nga kompanitë e mësipërme (http://www.inter.sa dhe http://www.afoimavroudi.gr/) **nuk kanë të drejtë shitjeje në Kosovë** ngase Albkos Safety Sh.p.k. është distributor i vetëm i autorizuar për Kosovë për shitjen, servisimin dhe mirëmbajtjen e produkteve të Mobiak SA.

   Meqenëse ne kemi pasur ndonjë kërkesë nga Profesional Alarm për tu furnizuar me pjesë rezervë të këtij prodhuesi, shtrohet pyetja si do të bëjë furnizimin me këto pjesë?

   Në anën tjetër, nëse e shikoni listën e çmimeve te OE Profesional Alarm për pjesët me të cilat ka ofertuar në pozicionet e sipërpërmendura, do të vëreni dallime në çmime prej 5 herë deri 15 herë nga ato reale të prodhuesit në fjalë, ngase ato janë vënë në mënyrë arbitrare gjë që është një indikator i qartë OE në fjalë nuk i ka kontaktuar kompanitë në fjalë, katalogjet e të cilave i ka shkarkuar nga faqet e tyre të internetit.

   Nëse do të kontaktoni kompanitë e sipërpërmendura do të vërtetoni se ato nuk do të jenë në gjendje për ta furnizuar OE e propozuar për kontratë (ngase nuk kanë të drejtë ta bëjnë një gjë të tillë), kurse kësaj

ankese ia bashkëngjisim dëshmi me të cilën vërtetohet se jemi distributor i vetëm i autorizuar i këtij prodhuesi.

Gjithashtu ju dërgojmë edhe një dëshmi të një rasti (nga disa të tilla) kur një OE i caktuar ka përdorur katalogë, përkatësisht emrin e këtij prodhuesi, për produkte të tjera te prodhuesçve të tjerë.

Provë 3: *09 _Non agent decalration.pdf*

Provë 4: *10 _Autorizimi Mobiak Albkos.pdf*

AK si përgjigje ndaj kërkesës tonë për rishqyrtim ka dhënë: ***"nuk është kërkuar autorizim nga prodhuesi"***, gjë që është e saktë por gjithsesi edhe me tutje ngelet e paqartë si do ta bëjë furnizimin.

2. Në pozicionin 4 dhe 13, në listën e çmimeve, OE Profesional Alarm nuk ka asnjë informacion qoftë për pajisjet me të cilat ka ofertuar apo edhe emrin e prodhuesit, ashtu siç është kërkuar me dosjen e tenderit ne ***Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 dhe 9.2.***

Sipas RRUOPP thuhet:

Është dorëzuar katalogu por mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69

3. Në ***pozicionin 1, Mbrojta nga zjarri në konvejer të ri (furnizimi, instalimi dhe testimi),*** OE ka ofertuar me pajisje te prodhuesit Bettati, Viking, Unipos etj., megjithatë OE nuk ka dhënë asnjë informacion të vetëm se cilat pajisje dhe elemente të sistemit do të përdoren me rastin e liferimit dhe instalimi, përkatësisht nuk ka dhënë as tipin e artikullit, as numrin e artikullit as madhësinë dhe sasitë që do të liferohen dhe instalohen.

Me këtë rast shtrohen pyetjet në vijim:

- Si është bërë vlerësimi nëse nuk dihen artikuj me të cilat ka ofertuar OE?
- Si do të bëhet pranimi i mallit në depot e KEK-ut kur nuk dihen as sasitë, as madhësitë e as llojet a artikujve me të cilat ofertuar OE?

Provë 5: Katalogjet e dorezuara nga OE per poz. 1
Dokumenti: *11 _KATALOKU SISTEMI I RI-.pdf*

Pra bazuar ve ne katalogjet e dorëzuara nga OE, komisioni vlerësues e ka pasur të pamundur për të bërë një vlerëim real, sepse nuk është matshëm, por është bërë pashuall duke i dhënë mundësi operatorit ekonomik për të liferuear produkte të çfarëdo lloji, madhësie dhe sasie, kurse në anën tjetër duke na vënë ne në pozitë të pabarabartë, meqenëse ne kemi precizuar çdo detaj me saktesi milimetrike.

Provë 6: Katalogjet e dorezuara dhe te specifikura nga Albkos Safety
Dokumenti: *12 _Kat. per poz. 1 Albkos Safety.pdf*

Një veprim i tillë do të jetë në dëm edhe të vet AK, pasi që ka ngelur hapur mundësia për të manipuluar si në cilësi, madhësi dhe sasi me rastin e dorëzimit të mallit dhe instalimit të sistemit, pasi OE të propozuar për tu shpërblyer me kontratë mund të dërgojë çfarë do të dëshirojë.

4. Sistemet aktuale të cilat duhet servisuar dhe që janë të instaluara janë të prodhuesit Mobiak S.A., ndërsa instalimi dhe servisimi i tyre, sipas prodhuesit të pajisjeve, nuk është i lejuar nga palë të treta që nuk janë të certifikuara nga prodhuesi i pajisjeve. Trajnimi dhe certifikimi nga prodhuesi, sipas standardeve Evropiane sipas të cilave janë te prodhuara këto pajisje, është kërkesë standarde dhe detyrim për secilin prodhues, në të kundërtën prodhuesi i pajisjeve nuk merr përgjegjësi për funksionimin e tyre.

OE Profesional Alarm, nuk ka personel të trajnuar dhe certifikuar nga prodhuesi Mobiak SA, qoftë për servisimin apo instalimin e pajisjeve të këtij prodhuesi, prandaj në rast zjarri dhe mosfunksionimit të pajisjeve në fjalë dhe dëmit eventual i cili mund të jetë shumë herë më i lartë se sa vlera e këtij tenderi, përgjegjësia do të bie ekskluzivisht mbi autoritetin kontraktues.

PËRFUNDIM:

Bazuar ne faktet e sipër përmendura është mese e qarte vlerësimi nuk është bere korrekt, prandaj kërkojmë të anulohet vendimi për dhënien e kontratës, të kthehet lënda në rishqyrtim si dhe të vendoset në favor të kompanisë tonë, duke qenë se jemi operator i përgjegjshëm me çmimin më të ultë.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëme materiale si pasojë e mos realizimit të fitimit të pritur, por edhe dëmet të tjera si pasojë e shpenzimeve të panevojshme shtesë në përgatitjen e ankesave, për të cilat ka qenë i nevojshëm angazhimi burimeve njerëzore dhe kosto shtesë.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

- 01 _B05 Njoftim per Kontratë.Pdf
- 02 _Procesverbali i hapjes.pdf
- 03 _NJOFTIM MBI VENDIMIN DHE LETER STANDARDE.pdf
- 04 _Kerkesë per qasje ne DT.pdf
- 05 _Konfirmimi per qasje.pdf
- 06 _KEK 14.03.2022 - Kerkese per rishqyrtim, Sist..pdf
- 07 _Ri-shqyrtimi i kerkeses.pdf
- 08 _KATALOGU SISTEMET EKZISTUESE.pdf
- 09 _Non agent decalration.pdf
- 10 _Autorizimi Mobiak Albkos.pdf
- 11 _KATALOKU SISTEMI I RI-.pdf
- 12 _Kat. per poz. 1 Albkos Safety.pdf